



MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 90, dt. 01.06.2015

Në mbështetje të nenit 47 të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 01.06.2015, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit të zbatimit Hec-Shpella Poshtë 2 (një shkallë), mbi përroin e Zallit, degë e lumit Shkumbin, Pogradec-Korçë, kërkesë e shoqërisë “Liria Energji” sh.p.k.
2. Ngarkohet shoqëria të kontribuojë për vendosjen e sinjalistikës dhe tabelave informuese për monumentin “ Shkëmbi i qytetit”, sipas projekt-preventivit të hartuar nga DRKK-ja Korçë.
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore punimet të mbikqyren nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI